



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 30 korrik 2015, në mbledhjen e XIX-të
(nëntëmbëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Lutfi Rexhepi, këshilltar i Kuvendit të Komunës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe:

- **Propozimi i Vendimi për lejimin e ndërrimit të destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore** (Për ndërtimin e objektit të Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël).

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri së bashku me propozimin e kryesuesit.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në takimi publik të Komitetit për Politikë dhe Financa me qytetarë më 16 qershor 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 25 qershor 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raporti i Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2014

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket këtij raporti përshtypje më ka bërë fakti se vërejtjet e auditimit janë të njëjta me ato të vitit 2013 dhe se rekomandimet a Auditorit të Përgjithshëm nuk janë marrë për bazë, që nënkupton se asnjë rekomandim nuk është plotësuar.

Mbikëqyrja e pasurisë së komunës në vazhdimësi nuk ka qenë në nivelin e duhur por edhe në vitin 2014 kemi mos regjistrimin e pasurisë në vlerë mbi 400.000 €, andaj kjo është përgjegjësi e evidente.

Sa i përket të hyrave vetanake, ka qenë kërkesë e disahershme e një pjese të këshilltarëve të Kuvendit për drejtorin e Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të interesohet për arkëtimin e qirasë të pronave të Komunës të dhëna në shfrytëzim, mirëpo unë kam identifikuar së paku 12 apo 13 prona me vlerë të lartë që drejtori i Drejtorisë së cekur nuk i ka përfshirë në listën e pronave komunale, listë të cilën ua ka shpërnda këshilltarëve të Kuvendit. Në veçanti shqetësim për mua paraqet fakti përse objekti i postës në fshatin Lluzhan dhe Mileniumi 2 në fshatin Orllan nuk janë paraqitur si prona komunale kur dihet se nga pronat e cekura Komuna ka mundësi të arkëton të hyra vetanake.

z. Haki Rudari, theksoi, sipas vlerësimit të Grupit të këshilltarëve të LVV – së, ky raport është fokusuar në radhë të parë në pasqyrat vjetore financiare, në reagimin e vitit paraprak dhe viteve të kaluara dhe së treti në çështjet e qeverisjes në veçanti menaxhimin financiar dhe kontrollit. Në faqen 5 të raporti thuhet “ Sistemi i kontrollit të brendshëm, i vendosur nga Komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha por ende kanë mbetur dobësi në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes “, dhe nëse thuhet se auditivi Komunën e ka gjetur në gjendje të mirë, ky konkluzion e demanton atë. Në këtë raport i kemi disa konkluzione të Auditorit të Përgjithshëm por në të njëjtën kohë i kemi edhe rekomandimet të drejtuara Kryetarit të Komunës dhe qeverisjes lokale.

Sipas konkluzioneve të këtij raporti vërehet se, klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike joadekuate, është një prej elementeve që duhet të merret si negative, në rastin e cekur nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 54,373 € për mallra dhe shërbime, pra edhe kjo është një prej dobësive që duhet të evidentohet. Çështja tjetër e cila vlen të theksohet është, mungesa e regjistrimit të pasurive të Komunës, lidhur me këtë thuhet: “ Ne kemi identifikuar se Komuna ka probleme me regjistrimin e pasurive të saj dhe kjo mund të rezultojë në nënvlerësimin material të vlerave të pasurive në tërësi ”, përndryshe kjo vërejtje ka qenë edhe në Raportin e vitit 2013.

Sa i përket rekomandimeve të vitit paraprak thuhet se një rekomandim është adresuar plotësisht, disa pjesërisht apo janë në proces të adresimit dhe një fare

nuk është adresuar, andaj jam i mendimit se në këtë drejtim duhet pasë kujdes ngase çështjet e njëjta po përsëriten në vazhdimësi.

Lidhur me procesin e llogaridhënies thuhet, pas rishikimit të kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar të Komunës, rezultojnë dobësi evidente në raportim të brendshëm, kjo ka të bëjë me atë se raportimet e drejtorëve të Drejtorive të Kryetari i Komunës bëhet, siç thuhet, ad-hoc, pra nuk ka raportime sistematike dhe në formë të shkruar.

Te dhënia me qira të pronës komunale është konstatuar se, në një rast Komuna kishte dhënë me qira përmes ankandit publik një lokal afërsisht 76 m² ku kriter për dhënie të lokalit ishte që përfituesi eventual ta bëjë parapagimin e qirasë për 6 muajt e parë, para se të nënshkruhet kontrata, mirëpo pagesa ishte bërë vetëm për tre muaj dhe atë pasi është nënshkruar kontrata, pra edhe kjo çështje nuk duhet të anashkalohet ashtu siç nuk mund të anashkalohen edhe shumë çështje të tjera dhe të thuhet se ky raport është i mirë.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, jam plotësisht dakord me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm, të gjetura të cilat janë publike, mirëpo duhet pasë parasysh definicionin i cili e përcakton opinionin e Auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare, faqe 29 e raportit, ku jepen sqarimet përse jepet opinionin i pamodifikuar dhe përse jepen opinionet tjera. Të shprehem në mënyrën më të thjeshtë, opinionin për Komunën e Podujevës është kalues me vërejtjet përkatëse.

Gjithashtu jam dakord se disa prej vërejtjeve janë të përsëritshme, shembull, sa i përket regjistrimit të pasurisë komunale, është e ditur se pagesat bëhen deri më 31 dhjetor të vitit fiskal përkatës, kur edhe mbyllet sistemi dhe nga kjo nuk mund të evidentohet në të njëjtën kohë edhe si pagesë edhe si pasuri, andaj kjo është arsyeja përse përsëritet kjo vërejtje e cila do të përsëritet edhe në të ardhmen, jo vetëm për Komunën e Podujevës por edhe për komunat të tjera. Në rastin konkret nuk ka të bëjë me ndonjë objekt por ka të bëjë me rrugë, kanalizime dhe pagesa të tjera të cilat bëhen në fund të vitit dhe nuk arrijnë të përfshihen në sistem për vitin fiskal përkatës por regjistrohen në vitin vijues fiskal.

Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake konsideroj se edhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës, gjatë bisedave me qytetarë në mjedise të ndryshme, do duhej të angazhohen për sensibilizimin e qytetarëve për përmbushjen e obligimeve financiare ndaj Komunës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, u përmend se disa vërejtje po përsëriten prej viti në vit, kjo mund të arsyetohet në mënyra të ndryshme por sipas mendimit tim nuk mund të arsyetohet raportimi jo i rregullt i drejtorëve të Drejtorive tek Kryetari i Komunës, apo siç thuhet në raport, raportime ad – hoc, andaj apeloj tek drejtorët që janë të pranishëm në këtë mbledhje të kenë parasysh këtë çështje në mënyrë që në raportet vijuese të mos na përsëritet vërejtja e këtyllë e do të ishte edhe më në rregull që vërejtjet e dhëna të evitohen dhe të mos përsëriten në vitin vijues.

z. Haki Rudari, theksoi, jam dakord me çështjen të cilën e ngriti drejtori z. Isuf Latifi, për angazhimin e këshilltarëve për sensibilizimin e qytetarëve që të paguajnë obligimet financiare ndaj Komunës, mirëpo konsideroj se së pari pjesëtarët e Ekzekutivit duhet të dalin nëpër lagjet e qytetit dhe nëpër fshatra e nëse janë të gatshëm të bashkëpunojnë me këshilltarët e Kuvendit dhe të bashkëbisedojnë me qytetarë, unë personalisht jam i gatshëm dhe e mbështes këtë iniciativë ngase jam

i bindur se nëse veprohet në këtë mënyrë shumë çështje do të përmirësohen në të mirë.

Gjatë bisedave në terren jam informuar se vërejtja më e madhe e qytetarëve është se fatura e tatimit në pronë nuk ju dërgohet në shtëpi dhe se për shumën e borxhit njoftohen kur kanë për të rregulluar ndonjë dokument përkatësisht kur e kërkojnë vërtetimin për pagesën e tatimit në pronë.

Sa i përket kontratave për shërbime të veçanta është identifikuar se janë 14 kontrata me kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj e ndër to ka edhe kontrata të lidhura që nga viti 2010, duke e marrë parasysh këtë vërejtje edhe një herë e përsëris si mund të thuhet se ky raport është i mirë.

z. Afrim Shabani, theksoi, sa i përket Raportit të auditimit për vitin 2014 jam mendimit se është një raport në të cilin janë paraqitur vërejtjet përkatëse të cilat janë publike.

Çështja e kontratave të cilën e ngriti z. Haki Rudari duhet të vlerësohet në aspektin më të gjerë ngase jemi në dijeni se në Institucionet komunale numri i të punësuarve është i kufizuar përkundër faktit se nevojat janë më të mëdha se numri i lejuar i të punësuarve, andaj në funksion të përmbushjes së obligimeve për ofrimin e shërbimeve përkatëse pranohen të punësuar me kontrata, pra kjo bëhet në kushtet dhe rrethanat aktuale që ne i kemi dhe atë derisa të bëhet ndonjë zgjidhje tjetër.

Përndryshe mbi 70% e raportit është pozitiv andaj duhet ta vlerësojmë si të tillë dhe në të ardhmen të bëjmë angazhime për evitimin e mangësive përkatëse.

z. Rafet Llapashtica, parafolësit iu drejtua, të gjithë ne jemi që punët e institucioneve të kryhen në mënyrën më të mirë, pra në rastet e nevojshme të pranohen me kontratë të përkohshme sipas dispozitave ligjore, mirëpo unë nuk e arsyetoj rastin në sektorin në të cilin e udhëhiqni në cilësinë e ushtruesit të detyrës së drejtorit apo Drejtorisë së Arsimit ku ka raste që për pushim të lehonisë disa lehonave pagesa u bëhet për gjashtë muaj e disa të tjerave për nëntë muaj, pra në rastet konkrete nuk kryhen kurrfarë punësh.

z. Afrim Shabani, theksoi, për të gjeturën e Auditorit të Përgjithshëm që e përmendi parafolësi, unë nga stafi kompetent i QKMF-së kam kërkuar që të identifikohet rasti përkatës, mirëpo jam informuar se një rast i tillë nuk ka ndodhur, andaj nuk mund të them se a ka të bëjë me ndonjë gabim apo diç tjetër, për këtë e kam njoftuar edhe drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, Raportin e Auditorit të Përgjithshëm askush nga ne nuk e konteston, sigurisht se janë të qarta edhe përparësitë por edhe mangësitë të cilat duhet të evitohen mbi bazën e rekomandimeve përkatëse.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2015

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se është mirë që Raportet financiare po shqyrtohet në periudha të caktuara, sa i përket Raportit për të cilin po debatojmë

kam vërejtur se përqindja e vogël te investimet kapitale është ngase për periudhën gjashtëmujore shuma prej 5.228.275 € janë shpenzuar 698. 809 që shprehur në përqindje është 13.36%, andaj do duhej që Kryetari i Komunës dhe Ekzekutivi në përgjithësi të merren me këtë çështje më seriozisht kur dihet se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë të shumta. Në këtë drejtim jam i mendimit se mungon edhe plani i shpenzimeve të Drejtorive përkatëse, që ne Grupi i këshilltarëve të LVV – së në vazhdimësi e kemi kërkuar.

Kodi 13509, pajisje të tjera nën 1000 €, në shumë prej 8.859,85 do të ishte më mirë të specifikohet se për çfarë pajisjesh bëhet fjalë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, vërejtja ime ka të bëjë me shumën e pagesës së mëditjeve jashtë vendi ngase shuma e akomodimit është e përafërt me shumën e mëditjeve që rezulton se mëditjet kanë qenë në vlerë të madhe. Pajtohem se udhëtimet jashtë vendi bëhen me qëllim për të sjellë ndonjë donacion, pra nuk jam kundër shpenzimeve për akomodim dhe mbulimit të shpenzimeve të tjera, por jam kundër ekstra mëditjeve.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, shuma e mëditjeve është e përcaktuar me Udhëzimin administrativ përkatës dhe shuma e shpenzuar e mëditjeve ka të bëjë për të gjithë zyrtarët e Komunës duke përfshirë edhe këshilltarët e Kuvendit të cilët disa herë kanë udhëtuar jashtë vendit.

z. Fidan Rekalju, theksoi, Raporti financiar për gjashtë mujorin e parë të këtij viti është raport i detajizuar në të cilin përshkruhen të gjitha të hyrat dhe të dalat financiare të Komunës së Podujevës, pra është raport i cili duhet të përshëndetet ngase ne jemi në dijeni se Komuna jonë është duke u zhvilluar dita ditës me infrastrukturë duke e përmirësuar mirëqenien e qytetarëve në të gjitha lokalitetet

z. Rafet Llapashtica, theksoi, këtë dokument publik për të cilin jemi duke debatuar shumica prej neve jemi në gjendje t'a trajtojmë afërsisht në mënyrë të njëjtë, pra nuk mund të themi se ndonjëri prej neve ka aftësi apo profesionalizëm më të madh. Nuk pajtohem me parafolësin ngase shembull po i marr shpenzimet e raportuara për fshatin Llaushë, sipas informacioneve që i kam asfalti nuk është shtruar fare.

Sa i përket zgjerimit të lumit dhe ndërtimit të urave, urat janë ndërtuar por zgjerimi i shtratit të lumit nuk është bërë ndërsa pagesa është bërë.

Ne po themi se pagesat e parakohshme për kompani përkatëse e kanë sjellë Komunën në krizë financiare, mirëpo mënyra e diskutimit të parafolësit me një fjali po na fut në debate të thella dhe po zgjaten mbledhjet nga tri apo katër orë.

Vërejtje e imja në cilësinë e anëtarit të këtij Komiteti dhe këshilltarit të Kuvendit është që kur pyetjen ia shtrojmë ndonjë drejtori të Drejtorisë të mos na japin përgjigje ndonjë prej anëtarëve apo kryesuesi i këtij Komiteti.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, u përmend çështje e pagesës për asfaltimin e rrugës në fshatin Llaushë, unë u befasova me çështjen e shtruar ngase një çështje e tillë nuk mund të ndodh, andaj, nga parafolësi, kërkoj të më sqaroj në mënyrë konkrete se për cilin rast bëhet fjalë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, informacionin për rrugën në fshatin Llaushë e kam marr nga z. Agim Xhemajli, qytetar i asaj treve dhe pjesëmarrës në debatin e Komitetit për Politikë dhe Financa me qytetarë.

z. Durim Salihu, theksoi, me përgjegjësi them se prej 5 shkurtit 2014, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që përmes menaxherit të projektit, t'i jap urdhëresë Zyrës së Prokurimit apo Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, të bëhet ndonjë pagesë për punët e pakryera

Pauzë 14,00' – 14,10'.

z. Isuf Latifi, theksoi, gjatë debatit u fol për mëditjet për udhëtim jashtë vendi, lidhur me këtë ekziston Rregullorja përkatëse e cila zbatohet për institucionet qendrore dhe lokale, andaj është e drejtë e çdonjërit i cili udhëton zyrtarisht të merr mëditjet në shumë të caktuar varësisht se në cilin shtet ka udhëtuar ngase tarifat janë të ndryshme.

U përmend projekti për zgjerimin e shtratit të lumit dhe ndërtimi i urave, është realizuar vetëm ndërtimi i urave dhe është bërë pagesa e punimeve përkatëse, mirëpo zgjerimi i lumit nuk ka ndodhë dhe për këtë nuk janë shpenzuar mjetet të destinuara për këtë qëllim, pra ky është sqarim vetëm sa i përket emërimit të projektit.

Sa i përket çështjes së tatimit në pronë, çdo vit lidhet kontrata me Postën për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë, andaj Posta është e obliguar që çdo tatimpaguesi të ja dërgojë faturën në shtëpi, mirëpo për shkak të çmimit më të shtrenjtë dërgimi nuk bëhet në formën rekomande në mënyrë që të vërtetohet që obliguesi tatimor a e ka pranuar apo jo faturën përkatëse. Natyrisht Posta deklarohet se e ka bërë shpërndarjen e të gjitha faturave, përveç 200 – 300 faturave, për të cilat thuhet se nuk është gjetur adresa, andaj vërejtjet e qytetarëve se nuk e kanë pranuar faturën e tatimit në pronë mund të konsiderohen të qëndrueshme derisa fatura nuk dërgohet në formën rekomande ku vërtetohet me nënshkrim pranimi i të njëjtës.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Informatë e Drejtorisë së Arsimit mbi përfundimin e vitit mësimorë 2014/2015

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, i njoftoi anëtarët e këtij Komiteti se në mbledhje është i pranishëm edhe z. Avni Maloku, i emëruar kohë më parë drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

z. Fidan Rekalii, theksoi, fjala hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës do të jepet edhe nesër në mbledhjen e Kuvendit, andaj unë jam i mendimit që kjo Informatë të mbështetet në parim dhe t'i rekomandojmë kuvendit për shqyrtim në mënyrë që t'i shmangemi debateve të dyfishta edhe në këtë Komitet edhe në Kuvend.

z. Haki Rudari, theksoi, pas përfundimit të gjysëmvetorit të parë kam kërkuar të paraqitet informata përkatëse mirëpo e njëjte nuk është përgatitur dhe nuk është shqyrtuar fare, derisa shumë komuna të tjera e kanë shqyrtuar atë çështje.

Tash është përfunduar viti shkollor 2014/2015, është mirë që është përgatitur kjo informatë, mirëpo konsideroj se është paksa e vonuar dhe e gjymtë ngase më tepër kemi të dhëna për gjysëmvetorin e dytë dhe sikur të kishim të dhëna sistematike nuk do të mund të thoshim se kjo Informatë është e gjymtë.

Do të ishte mirë që në këtë Informatë të inkorporohen edhe vërejtjet dhe vështirësitë me të cilat janë përballë gjatë vitit përkatës shkollor.

Ne e kemi ngritur Komitetin për Arsim dhe Kulturë i cili nuk e ka mbajtur asnjë mbledhje derisa po e zëmë në Komunën e Gjilanit informatën e cekur së pari e shqyrton Komiteti i Arsimit e pastaj Kuvendi i Komunës, andaj do të ishte mirë që një praktikë e tillë të zbatohet edhe në Komunën e Podujevës.

z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi, theksoi, Informata mbi përfundimin e vitit shkollor 2014/2015 është mirë e përgatitur dhe e detajuar dhe janë paraqitur të gjitha çështjet e rëndësishme. E shfrytëzoj rastin dhe i përgëzoj nxënësit të cilët në gara të ndryshme kanë arritur rezultate mjaftë të mira dhe atë në gara rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare. Te gara shtetërore të organizuar nga Kolegji “ Mehmet Akif “ , në lëndën e kimisë ka mbet pa u përfshirë edhe një certifikatë e artë, certifikatë e fituar nga nxënësit e SHFU “ Naim Frashëri “, andaj edhe kjo e dhënë është mirë të përfshihet në të arriturat e nxënësve.

z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, Informata për të cilën po debatohet, sipas mendimit tim, i adreson çështjet më të rëndësishme për periudhën e caktuar e në veçanti i adreson tri çështje, së pari përfundimi i vitit shkollor por me këtë ndërlidhet edhe regjistrimi i nxënësve në kl. I^{te} që bëhet në muajt maj dhe qershor si dhe regjistrimin e nxënësve në kl. X^{ta}, së dyti rezultatet e testit të arrijtëshmërisë dhe testit të maturës dhe e fundit çështja e rezultateve e të arritura të nxënësve tanë në gara të ndryshme, garat komunale që janë tradicionale nuk janë përfshirë, ndërsa sa i përket çështjes të cilën e ngriti parafolësja, nuk mund të them përse në këtë dokument nuk është përfshirë certifikata e cekur.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

6. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jemi në dijeni për gjendjen e rrjetit të energjisë i cili domosdo duhet të ndërrohet, mirëpo sipas një zyrtari të KEK – ut qytetarët nuk janë të obliguar të paguajë energjinë elektrike nëse në dalje tensioni nuk është 220 kw, ndërsa realiteti është i ditur, andaj do duhej pasur kujdes në këtë drejtim. Në fshatin Kunushec trafoja është vendosur në pronën publike me kulturë rrugë, andaj jam i interesuar të di përse është vepruar në këtë mënyrë.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

7. Propozim vendimet për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Fadil Latifit nga fshati Llapashticë e Poshtme dhe Mustaf Abazit nga fshati Sallabajë)

Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

8. Propozimi i Vendimi për lejimin e ndërrimit të destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Për ndërtimin e objektit të Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeçël).

Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.20'

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-70400
Podujevë,
30 korrik 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**